



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 17 dt. 30.05.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 30.05.2014, pasi shqyrtoi kërkesën për konfirmim të shoqërisë “BREMA AMBIENTE” SHPK, për zhvillimin dhe përdorimin e zonës ekonomike (park industrial), Rrashbull, Durrës,

VENDOSI:

1. Shoqëria “BREMA AMBIENTE” SHPK, duhet t’i drejtohet Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik për të firmosur kontratën dy palëshe mes Shoqërisë dhe ASHA.
2. Bazuar në nenin 47 të ligjit “Për Trashëgiminë Kulturore”, KKR jep miratim për fillimin e punimeve për shoqërinë “BREMA AMBIENTE” SHPK, për zhvillimin dhe përdorimin e zonës ekonomike (park industrial), Rrashbull, Durrës
3. Kryerja e të gjithë procedurave të realizohet nën supervizimin e Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI